

**VENDIM****Nr. 1054, datë 23.12.2015****PËR MIRATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK “PËR PËRPUTHSHMËRINË
ELEKTROMAGNETIKE”² DHE
PËRCAKTIMIN E LISTËS SË
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve pika 17, 5, pika 2, 3, pika 17, 6 dhe 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për përputhshmërinë elektromagnetike”, sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.

2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve, referuar në pikën 1, sipas listës bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.

3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve, referuar në pikën 1, me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministria Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

² Direktiva 2004/108/EC, datë 15 dhjetor 2004, “Mbi përfrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përputhshmërinë elektromagnetike”, që shfuqizon Direktivën 89/336/EEC, Numri Celex 32004L0108; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 390, datë 31.12.2004, faqe 24-37.

**RREGULL TEKNIK****PËR PËRPUTHSHMËRINË ELEKTROMAGNETIKE****1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

1.1. Ky Rregull Teknik rregullon përputhshmërinë elektromagnetike të paisjeve dhe ka si qëllim të sigurojë që tregu i brendshëm të ketë pajisje me një nivel të kënaqshëm të përputhshmërisë elektromagnetike.

Ky Rregull Teknik zbatohet për pajisjet e dhëna në pikën 2.

1.2. Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për:

- a) pajisjet e radiove dhe terminaleve të telekomunikacioneve;
- b) Produktet, pjesët dhe aplikimet aeronautike;
- c) Pajisje radio të përdorura nga radioamatorët, nëse pajisjet nuk janë bërë të disponueshme në treg. Pjesët përbërëse që montohen nga radioamatorët dhe pajisjet tregtare të modifikuara dhe të përdorura nga radioamatorët nuk konsiderohen pajisje të disponueshme për treg;

1.3 Ky Rregull Teknik nuk zbatohet ndaj pajisjeve, natyra e brendshme e karakteristikave fizike e të cilës është e tillë që:

- a) ajo nuk gjeneron ose të kontribuojë në emetime elektromagnetike që kalojnë nivelin e lejuar për pajisjet radio dhe telekomunikacionit gjatë funksionimit sipas qëllimit të paracaktuar
- b) ajo funksionon normalisht sipas qëllimit të paracaktuar të përdorimit, për përkeqësime të papranueshme, edhe në prezencën e çrregullimeve elektromagnetike.

1.4. Kur kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 5 janë tërësisht apo pjesërisht më të specifikuar në Rregulla të tjerë Teknik, ky Rregull Teknik nuk zbatohet për pajisjet e përcaktuara në nënpikën 1.1, ose nuk zbatohen vetëm ato kërkesa që janë të përcaktuara në këto Rregulla Teknik.

1.5. Ky Rregull Teknik nuk ndikon në zbatimin e kërkesave ligjore të lidhur me sigurinë e pajisjeve.

2. Përkufizime

2.1 Për qëllime të këtij Rregulli Teknik zbatohen termat e mëposhtëm:

- a) “Pajisje” është çdo aparat, ose instalim i palëvizshëm,
- b) “aparat” është çdo mekanizëm përfundimtar, ose kombinim i tyre që bëhet i disponueshëm në treg si njësi e vetme funksionale, i destinuar për përdoruesin e fundit dhe që prodhon çrregullime elektromagnetike, ose funksionimi i të cilit ndikohet nga këto çrregullime,
- c) “instalim i palëvizshëm” është kombinim i veçantë i disa tipe aparatësh, dhe sipas rastit mekanizma të tjerë, të montuar, të instaluar dhe të destinuar për t’u përdorur në mënyrë të përherëshme në një vënd të paracaktuar,
- ç) “përputhshmëria elektromagnetike” është aftësia e pajisjes për të funksionuar kënaqshëm në mjedisin e saj elektromagnetik pa paraqitur çrregullime elektromagnetike të patolerueshme ndaj pajisjeve të tjera në këtë mjedis,
- d) “çrregullim elektromagnetik” është çdo fenomen elektromagnetik që mund të prishë efektshmërinë e pajisjes. Një çrregullim elektromagnetik mund të jetë një zhurmë elektromagnetike, një sinjal i padëshiruar ose një ndryshim në vetë mediumin transmetues,
- dh) “imunitet” është aftësia e pajisjes që të funksionojë sipas qëllimit të paracaktuar pa dëmtonur efektshmërinë e saj në prezencë të një çrregullimi elektromagnetik,
- e) “qëllime të sigurisë” janë qëllime në lidhje me masat mbrojtëse të jetës njerëzore dhe pronësisë,
- ë) “mjedis elektromagnetik” nenkupton të gjitha fenomenet elektromagnetike të vëzhgueshme në një zonë të caktuar.

2.2. Për qëllime të këtij Rregulli Teknik konsiderohet aparat edhe:



- a) “elementë përbërës” ose “nën-montim” i destinuar të përfshihet në një aparat nga përdoruesi i fundit, dhe që mund të prodhohë çregullime elektromagnetike, ose funksionimi i të cilit rrezikon të influencohet nga çregullime të tilla,
- b) “instalim i lëvizshëm” i përcaktuar, si një kombinim i aparateve dhe sipas rastit, mekanizmave të tjera, të destinuara që të levizen dhe të funksionojnë në vendndodhje të ndryshme.

3. Vendosja në treg dhe ose në shërbim

Struktura Përgjegjëse e Mbikëqyrjes së Tregut nën Ministrinë përgjegjëse për tregtinë (me poshtë SPMT) merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet vendosen në treg dhe ose në shërbim vetëm nëse ato plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli Teknik kur instalohen mirëmbahen dhe përdoren brenda qëllimit të parashikuar.

4. Lëvizja e lirë e pajisjeve

4.1 Nuk ndalohet as kufizohet vendosja në treg dhe/ose në përdorim e pajisjeve që janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

4.2 Kërkesat e këtij Rregulli Teknik nuk ndalojnë aplikimin e masave specifike të mëposhtme, në lidhje me vënien në shërbim ose përdorim të pajisjes si:

a) masa për të kapërcyer një problem ekzistues ose të parashikueshëm të përputhshmërisë elektromagnetike në një mjedis të caktuar;

b) masa të marra për arsye sigurie, në një situatë me një diapazon të përcaktuar mirë, kur përdoren për mbrojtjen e rrjeteve publike të telekomunikacionit ose stacionet e marrjes ose të transmetimit

4.3 Pajisjet që nuk janë në përputhje me këtë Rregull Teknik mund të paraqiten apo të demonstrohen në panairë tregtare apo në aktivitete të tilla të ngjashme, vetëm nëse një shenjë e dukshme tregon qartë që këto pajisje nuk do të vendosen në treg derisa të sillen në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik. Demonstrimi mund të kryhet vetëm nëse merren të gjitha masat për të shmangur çregullimet elektromagnetike.

5. Kërkesat thelbësore

5.1 Kërkesat mbrojtëse

Pajisjet projektohen dhe prodhohen në mënyrë që, duke patur parasysh nivelin e zhvillimit teknologjik, të sigurojnë që:

a) çrregullimet elektromagnetike të prodhuara prej saj nuk duhet të tejkalojnë nivelin mbi të cilin pajisjet e radios dhe telekomunikacioneve ose pajisjet e tjera nuk mund të funksionojnë sipas qëllimit të paracaktuar,

b) të kenë një nivel të mjaftueshëm imuniteti ndaj çrregullimeve elektromagnetike të pritshme në përdorimin e saj sipas qëllimit të paracaktuar, që e lejon atë të funksionojë pa përkeqësim të papranueshëm përdorimin e pajisjes sipas këtij qëllimi.

5.2 Kërkesa specifike për instalimet e palëvizëshme

Instalimet e palëvizëshme instalohen duke aplikuar praktikat më të mira inxhinierike dhe duke respektuar informacion për përdorimin e paparashikuar të elementëve përbërës, me synim që të plotësojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në nënpikën 5.1.

Këto praktika të mira inxhinierike duhet të dokumentohen dhe personi përgjegjës duhet ti mbajë në dispozicion të SPMT për qëllime inspektimi për sa kohë që instalimi i palëvizshëm vashdon të jenë në funksionim.

6. Aparatet

6.1 Proçedura e vlerësimit të konformitetit për aparatet

Përputhshmëria e aparatit me kërkesat thelbësore referuar në pikën 5 të këtij Rregulli Teknik, demonstronhet sipas proçedurës të dhënë në nënpikën 6.2



Megjithate, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mund të zgjedhë dhe procedurën e përshkruar në nënpikën 6.3

6.2 Kontrolli i brendshëm në prodhim

6.2.1 Prodhuesi duhet të kryejë një vlerësim të përputhshmërisë elektromagnetike të aparatit mbi bazën e fenomenit përkatës me qëllim për të plotësuar kërkesat mbrojtese të përcaktuara në nënpikën 5.1.

Zbatimi korrekt i të gjitha standardeve të harmonizuara, sipas listës bashkëlidhur siç referohet në pikën 2 të këtij vendimi duhet të jetë ekuivalent me kryerjen e vlerësimit të përputhshmërisë elektromagnetike.

6.2.2 Vlerësimi i përputhshmërisë elektromagnetik duhet të marrë parasysh të gjitha kushtet normale për funksionimin sipas qëllimit të paracaktuar.

Nëse aparati mund të konfigurohet në mënyra të ndryshme, vlerësimi i konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike duhet të konfirmojë nëse aparati i plotëson kërkesat mbrojtese të përcaktuara në nënpikën 51, në të gjitha konfigurimet e mundshme të përdorshme sipas qëllimit të paracaktuar, të identifikuara nga prodhuesi apo përfaqësuesi i tij.

6.2.3 Prodhuesi, në përputhje me nënpikën 7.4 duhet të hartojë dokumentacionin teknik për të treguar përputhjen e aparatit me kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik.

6.2.4 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të mbajë dokumentacionin teknik në dispozicion të SPMT, për qëllime inspektimi, të paktën për 10 vjet pas prodhimit për herë të fundit të një aparati të tillë.

6.2.5 Përputhshmëria e aparatit me të gjitha kërkesat thelbësore përkatëse dëshmohet nga deklarata EC e konformitetit e lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

6.2.6 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban deklaratën e konformitetit EC, si dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të SPMT të paktën për 10 vjet pas prodhimit për herë të fundit të një aparati të tillë.

6.2.7 Kur si prodhuesi ashtu edhe përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk janë të vendosur në Shqipëri, detyrimin për mbajtjen e dokumentacionit teknik në dispozicion është përgjegjësi e personit që vendos pajisjen në treg.

6.2.8 Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që aparatet janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik të referuar në nënpikën 7.2.3, dhe me dispozitat e këtij Rregulli Teknik që zbatohet për to.

6.2.9 Dokumentacioni teknik dhe deklarata e konformitetit hartohen në përputhje me dispozitat e dhëna nënpikën 6.4.

6.3 Procedura e vlerësimit të konformitetit

6.3.1 Kjo procedurë konsiston në zbatimin e procedurës të referuar në nënpikën 6.2 e ndjekur pastaj me procedurën si më poshtë:

6.3.2 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të paraqesë tek një organizëm evropian i notifikuar/degës së tij të regjistruar dhe miratuar në Shqipëri nga Ministri përgjegjës për tregtinë (këtu e më poshtë OEN/OM) dokumentacionin teknik, sipas të cilit i kërkohet këtij OEN/OM të kryejë vlerësimin.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i përcakton këtij OEN/OM ato aspekte specifike të kërkesave thelbësore të cilat duhet të vlerësohen nga ky OEN/OM.

6.3.3 OEN/OM i përzgjedhur duhet të shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe të vlerësojë nëse dokumentacioni teknik demonstroi që kërkesat e Rregullit Teknik janë plotësuar;

Nëse konfirmohet përputhshmëria e aparatit, OEN/OM duhet të lëshojë një deklaratë për prodhuesin apo përfaqësuesin e tij të autorizuar që konfirmon përputhshmërinë e aparatit.

Kjo deklaratë duhet të jetë e kufizuar vetëm ndaj atyre aspekteve të veçanta të kërkesave thelbësore të cilat janë vlerësuar nga ky OEN/OM.

6.3.4 Prodhuesi duhet të përfshijë në dokumentacionin teknik dhe deklarinimin e lëshuar nga ky OEN/OM.

6.4 Dokumentacioni teknik dhe deklarata EC e konformitetit

6.4.1 Dokumentacioni Teknik

Dokumentacioni teknik mundëson vlerësimin e konformitetit të aparatit në përputhje me kërkesat e vleresuara thelbësore. Ai duhet të përfshijë projektimin dhe prodhimin e aparatit dhe në veçanti:

- a) një përshkrim i përgjithshëm i aparatit,
- b) evidencën e përputhshmërisë me standardet e harmonizuara, nëse ka të tillë, të zbatuara pjesërisht apo plotësisht,
- c) kur prodhuesi nuk ka zbatuar standardet e harmonizuar ose i ka zbatuar ato pjesërisht, një përshkrim dhe shpjegim të masave të ndërmarra për të plotësuar kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik, duke përfshirë një përshkrim të vlerësimit të përputhshmërisë elektromagnetike të dhënë në nënpikën 6.2.1, rezultatet e llogaritjeve të bëra gjatë projektimit, shqyrtimet e kryera, raportet e provave, etj,
- ç) një dëshmi të OEN/OM, kur është ndjekur procedura e përcaktuar në nënpikën 6.3;

6.4.2 Deklarata EC e konformitetit

Deklarata EC e konformitetit duhet të përmbajë së paku:

- a) një referimin të këtij Rregulli Teknik,
- b) identifikimin e aparatit të cilit i referohet, sipas përcaktimit në nënpikën 8.1,
- c) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe sipas rastit emrin dhe adresën e përfaqësuesit të tij të autorizuar,
- ç) një referencë me të dhëna për specifikimet, sipas të cilave konformiteti i deklaruar siguron përputhshmërinë e aparatit me dispozitat e këtij Rregulli Teknik,
- d) datën e deklarimit,
- dh) identitetin dhe firmën e personit të autorizuar të lidhur me detyrimet e prodhuesit apo përfaqësuesin e autorizuar të tij.

7. Markimi CE


7.1 Aparatet, përputhshmëria e të cilave me këtë Rregull Teknik është përcaktuar sipas procedurës të përshkruar në pikën 6, duhet të mbajnë markimin CE, markim që dëshmon këtë fakt. Vendosja e markimit CE është përgjegjësi e prodhuesit ose e përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Markimi CE vendoset në përputhje me nënpikën 7.4.

7.2 Merren masat e nevojshme për të parandaluar vendosjen në aparate, në paketimin e tyre ose në instruksionet e tyre të përdorimit të shenjave të cilat mund të çorientojnë palët e treta në lidhje me kuptimin dhe/ose formën grafike të markimit CE.

7.3 Në aparat, në paketimin e tij ose në instruksionet e përdorimit mund të vendoset çdo markim tjetër por me kushtin që të mos pengojë dukshmërinë dhe lexueshmërinë e markimit CE.

7.4 Markimi CE përbëhet nga inicialet CE dhe ka formën e mëposhtme:



Markimi CE duhet të ketë një lartësi jo më të vogël se 5 mm. Nëse markimi CE zvogelohet ose zmadhohet, duhet të respektohen përpjestimet e vizatimit të dhënë më lart.

Markimi CE duhet të vendoset në aparat ose në pllaketën e saj të të dhënave. Nëse nuk është e mundur për shkak të natyrës së aparatit, ajo duhet të vendoset në ambalazh nëse ka, dhe në dokumentat shoqërues.



Nëse aparati është subjekt dhe i Rregullave të tjera Teknike që përfshijnë aspekte të tjera dhe që gjithashtu parashikojnë vendosjen e markimit CE, ky i fundit tregon se aparati në fjalë është në konformitet dhe me këto Rregulla Teknike.

Megjithatë kur një ose më shumë nga këto Rregulla Teknike i lejojnë prodhuesit që gjatë një periudhe tranzitore të zgjedhë cilat dispozita të zbatojë, markimi CE tregon vetëm konformitetin me Rregullat Teknike të zbatuara nga prodhuesi.

Në këtë rast, dispozitat e Rregullave Teknike të zbatuara, duhet të tregohen në dokumentat, shënimet apo instruksionet e kërkuara nga Rregullat Teknike që shoqërojnë pajisjen

8. Informacioni dhe shënimet e tjera

8.1 Çdo aparat duhet të identifikohet në lidhje me tipin, madhësinë e partisë, numrine serisë dhe çdo informacion tjetër që mundëson identifikimin e aparatit.

8.2 Çdo aparat duhet të shoqërohet nga emri dhe adresa e prodhuesit, ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, ose i personit përgjegjës që vendos aparatin në treg.

8.3 Prodhuesi duhet të sigurojë informacion për çdo lloj mase paraprake specifike që merret për të montuar, instaluar, mirëmbajtur ose përdorur aparatin, në mënyrë që të sigurohet që kur të vendoset në shërbim, aparati të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik të dhëna në nënpikën 5.1,

8.4 Aparatet për të cilat përputhshmëria me kërkesat e mbrojtjes nuk sigurohen për në zonat e banuara, duhet të shoqërohen nga një tregim i qartë i këtij kufizimi në përdorim, dhe nëse është e mundur edhe në paketim.

8.5 Informacioni i kërkuar për të mundësuar përdorimin e aparatit sipas qëllimit të paracaktuar përfshihet në instruksionet që shoqërojnë aparatin.

9. Siguria

9.1 Kur SPMT konstaton që aparati me markimin CE nuk është në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, ajo duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme për pezullimin ose tërheqjen nga tregu të këtij aparati, ndalimin e vendosjes në treg dhe në përdorim, apo për kufizimin e qarkullimit të tij të lirë.

9.2. SPMT menjëherë informon Ministrin përgjegjës për tregtinë për këto masa, duke saktësuar arësytet dhe duke specifikuar në mënyrë të veçantë, nëse mospërputhshmëria ka të bëjë me:

a) mospërmbushje të kërkesave thelbësore të referuara në pikën 5 të këtij Rregulli Teknik, kur aparati nuk është në përputhje me standardet e harmonizuar përkatës sipas listës bashkëlidhur siç referohet në pikën 2 të këtij vendimi,

b) zbatim jo korekt të standardeve të harmonizuar përkatës,

c) pezullimin e standardeve të harmonizuar

9.3 Kur mospërputhshmëria e aparatit ka qënë subjekt i procedurave të vlerësimit të konformitetit të referuara sipas nënpikës 6.6.3, Ministri përgjegjës për tregtinë merr masat në lidhje me OEN/OM si autor të deklaratës së konformitetit të referuar në nënpikën 6.3.3.

10. Vendimet mbi pezullimin ose tërheqjen nga tregu të pajisjes

10.1 Çdo vendim i marrë nga SPMT kundrejt kërkesave të këtij Rregulli Teknik për pezullimin ose tërheqjen nga tregu të këtij aparati, apo për kufizimin e qarkullimit të tij të lirë duhet të jetë i bazuar, i argumentuar dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit. Këto vendime i njoftohen operatorit ekonomik, siç parashikohet në nenin 38 të ligjit 2011/10489

10.2 Në rastin e një vendimi referuar në pikën 1, operatorit ekonomik i komunikohet paraprakisht masa dhe i jepet mundësia e dhënies së argumenteve, përveç rasteve urgjente të justifikuara në respekt të kërkesave të ruajtjes së shëndetit, sigurisë së qytetareve dhe interesit publik, në përputhje me nenin 33 të ligjit 2011/10489.

11. Organet e miratuara OEN/OM



11.1 Ministri përgjegjës për tregtinë miraton OEN/OM t për kryerjen e detyrave referuar në pikën 6.3 dhe që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.10489. Në vendimin e miratimit përcaktohet nëse këto organe janë miratuar për kryerjen e detyrave që referohen në pikën 6.3 për të gjitha aparatet që mbulojnë nga ky Rregull Teknik, dhe/ose kërkesat thelbësore apo fusha e miratimit është e kufizuar në disa aspekte specifike dhe/ose në disa kategori aparatësh.

11.2 Organet që plotësojnë kriteret vlerësuese të përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara prezumohen se plotësojnë kërkesat e miratimit që referohen në ligjin nr.10489.

11.3 Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit dhe fushat për të cilat ato janë miratuar.

12 Instalimet e palëvizshëm

12.1 Aparati që është vendosur në treg dhe që mund të përfshihet në një instalim të palëvizshëm, i nënshtrohet të gjitha dispozitave përkatëse për aparatet të parashikuara në këtë Rregull Teknik.

Dispozitat e pikave 5,6,7 dhe 8 nuk janë detyruese në rastin e aparateve të destinuara për të qënë pjesë përbërëse në një instalim të palëvizshëm të përcaktuar dhe që nuk janë të disponueshme në treg. Në raste të tilla, dokumentacioni shoqëruar identifikon instalimin e palëvizshëm dhe karakteristikat e tij që lidhen me përputhshmërinë elektromagnetike dhe tregon masat paraprake që duhen marrë për të përfshirë aparatit në instalimin e palëvizshëm, me qëllim që të ruhet përputhshmëria e këtij instalimi me këtë Rregull Teknik. Dokumentacioni përfshin gjithashtu edhe informacionin e nënpikës 8.1 dhe 8.2.

12.2 Kur ka tregues të mos konformitetit të instalimit të palëvizshëm, në mënyrë të veçantë kur ka ankese që kanë të bëjnë me çrregullimet elektromagnetike të prodhuara nga instalimi, SPMT mund të kërkojë evidenca të konformitetit të instalimit të palëvizshëm në fjalë, dhe nëse është e nevojshme, fillimin e një vleresimi.

Kur mos konformiteti është konfirmuar, SPMT urdhëron masa të përshtatshme ndaj personit përgjegjës për vendosjen e instalimit, për ta sjellë instalimin e palëvizshëm, në konformitet me kërkesat mbrojtëse të përcaktuara në nënpikën 5.1



LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE LIDHUR ME PERPUTHSHMERINE ELEKTROMAGNETIKE

NR	Titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1.	S SH EN 617:2001+A1:2010 Pajisje dhe sistemet të furnizimit të vazhdueshëm - Kërkesat e sigurisë dhe të përputhshmërisë elektromagnetike për pajisjet e ruajtjes së materialit rifuzo në silo, bunkerë, kova dhe hinka	2011	Fp
2.	S SH EN 618:2002+A1:2010 Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për pajisjet për transportimin mekanik të materialeve rifuzo, përveç konvejerëve me shirit të fiksuar	2011	Fp
3.	S SH EN 619:2002+A1:2010 Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për pajisjet për transportimin mekanik të ngarkesave njësi	2011	Fp
4.	S SH EN 620:2002+A1:2010 Pajisjet dhe sistemet për transportimin e vazhdueshëm - Kërkesat për sigurinë dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për konvejerët me shirit të fiksuar për transportimin e materialit rifuzo	2011	Fp
5.	S SH EN 1155:1997 Aksesorë, (brava, shula, reze, etj.) për ndërtesat - Pajisjet elektrike të mbajtjes hapur për dyert rrotulluese - Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
6.	S SH EN 12015:2014 Përputhshmëria elektromagnetike - Standarde të familjes së produkteve për ashensorët, shkallët lëvizëse dhe konvejerët për pasagjerë - Emetimi	2014	Fp
7.	S SH EN 12016:2013 Kompatibiliteti elektromagnetik - Standarde të familjes së produkteve për ashensorët, shkallët lëvizëse dhe vendkalimet lëvizëse - Imuniteti	2014	Fp
8.	S SH EN 12895:2000 Rimorkiot për mirëmbajtje - Përputhshmëria elektromagnetike.	2006	Fp



9.	S SH EN 13241-1:2003+A1:2011 Dyer dhe porta industriale, tregtare dhe të garazheve - Standard produkti - Pjesa 1: Produkte pa rezistencë ndaj zjarrit ose karakteristikat e kontrollit të tymit	2012	Fp
	S SH EN 13309:2010 Makinertë e ndërtimit - Përputhshmëria elektromagnetike e makinave me furnizim të brendshëm të energjisë elektrike	2011	Fp
10.	S SH EN 14010:2003+A1:2009 Siguria e makinerisë - Pajisje për parkimin e motorizuar të automjeteve - Siguria dhe kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike për projektimin, prodhimin, montimin dhe vënien në punë	2006	Fp
11.	S SH EN ISO 14982:2009 Makinertë bujqësorë dhe për pyjet - Përputhshmëria elektromagnetike - Metodat e provave dhe kriteret e pranimit	2009	Fp
	S SH EN 16361:2013 Dyer te motorizuara per këmbësor - Standardet e produktit,karakteristikat e performancës - Kompletet e dyerve për këmbësor,me ritëm te ndryshëm,fillimisht të dizenuara për tu montuar te motorizuara pa karakteristikat e rezistencës nga zjarri dhe rrjedhjes së tymit	2014	Fp
12.	S SH EN 50065-1:2011 Transmetimi i sinjalit në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148.5 kHz - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme, bandat e frekuencës dhe çregullimet elektromagnetike	2013	Fp
13.	S SH EN 50065-2-1:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-1: Kërkesat për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të përdoren në mjediset residenciale, tregtare dhe të industrisë së lehtë	2007	Fp
	S SH EN 50065-2-1:2003/A1:2005		Fp
	S SH EN 50065-2-1:2003/AC:2003	2011	Fp
14.	S SH EN 50065-2-2:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-2: Kërkesa për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të	2007	Fp



	përdoren në mjediset industriale		
	S SH EN 50065-2-2:2003/A1:2005		Fp
	S SH EN 50065-2-2:2003/AC:2003	2011	Fp
	S SH EN 50065-2-2:2003/A1:2005/AC:2006	2013	Fp
15.	S SH EN 50065-2-3:2003 Specifikime për sinjalizimin në instalimet elektrike me tension të ulët në diapazonin e frekuencave 3 kHz deri 148,5 kHz - Pjesa 2-3: Kërkesa për imunitetin për aparatet dhe për sistemet e komunikimit në rrjetin elektrik, që punojnë në bandën e frekuencave nga 95 kHz deri 148,5 kHz dhe që parashikohen të përdoren nga furnizuesit dhe shpërndarësit e energjisë elektrike	2007	Fp
	S SH EN 50065-2-3:2003/A1:2005		Fp
	S SH EN 50065-2-3:2003/AC:2003	2011	Fp
16.	S SH EN 50083-2:2012 Rrjete kabllore për sinjalet televizive, sinjalet e zërit dhe shërbimet interaktive - Pjesa 2: Pajtueshmëria elektromagnetike për pajisjet	2013	Fp
17.	S SH EN 50121-1:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 1: Të përgjithshme	2008	Fp
	S SH EN 50121-1:2006/AC:2008	2011	Fp
18.	S SH EN 50121-2:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 2: Emetimi i sistemit të plotë hekurudhor në mjedisin e jashtëm	2008	Fp
	S SH EN 50121-2:2006/AC:2008	2011	Fp
19.	S SH EN 50121-3-1:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 3-1: Vagoni - Mjetet e trenit dhe të tjerat	2008	Fp
	S SH EN 50121-3-1:2006/AC:2008	2011	Fp
20.	S SH EN 50121-3-2:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 3-2: Vagoni - Aparatet	2008	Fp
	S SH EN 50121-3-2:2006/AC:2008	2011	Fp



21.	S SH EN 50121-4:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 4: Emetimi dhe imuniteti i aparateve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit	2008	Fp
	S SH EN 50121-4:2006/AC:2008	2011	Fp
22.	S SH EN 50121-5:2006 Përdorime hekurudhore - Përputhshmëria elektromagnetike - Pjesa 5: Emetimi dhe imuniteti i instalimeve dhe aparateve fikse të ushqimit të fuqisë	2008	Fp
	S SH EN 50121-5:2006/AC:2008	2011	Fp
23.	S SH EN 50130-4:2011Sistemet e alarmit - Pjesa 4: Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit: Kërkesat e imunitetit për komponentët e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrësi, vjedhja, CCTV, për kontrollin e hyrjes dhe sistemet sociale të alarmit	2011	Fp
24.	S SH EN 50148:1995 Taksimetri elektronik	2008	Fp
25.	S SH EN 50270:2006 Electromagnetic compatibility - Electrical apparatus for the detection and measurement of combustible gases, toxic gases or oxygen	2008	Fp
26.	S SH EN 50293:2000 Përputhshmëria elektromagnetike - Sistemet e sinjalizimit për trafikun rrugor - Standardi i produktit	2007	Fp
27.	S SH EN 50293:2012 Sistemet e sinjalizimit të trafikut rrugor - Përputhshmëria elektromagnetike	2013	Fp
28.	S SH EN 50295:1999 Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët - Sistemet e kontrollit dhe pajisjes ndërfaqësuese - Pajisjet ndërfaqëse me sensor aktualizues	2005	Fp
29.	S SH EN 50370-1:2005 Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit për veglat e makinerisë - Pjesa 1: Emetimi	2008	Fp
30.	S SH EN 50370-2:2003 Përputhshmëria elektromagnetike - Standardi i familjes së produktit për veglat e makinerisë - Pjesa 2: Imuniteti	2008	Fp
31.	S SH EN 50412-2-1:2005 Sistemet dhe aparatet e linjave të komunikimit të fuqisë të përdorura në instalimet e tensionit të ulët në diapazonin e frekuencave 1,6 MHz deri në 30 MHz - Pjesa 2-1: Ambientet	2008	Fp



	rezidenciale, tregtare dhe industriale - Kërkesat e imunitetit		
	S SH EN 50412-2-1:2005/AC:2009	2011	Fp
32.	S SH EN 50428:2005 Çelësat për instalimet elektrike të fiksuara shtëpiake dhe pajisje të ngjashme me to - Standard shtesë - Çelësat dhe aksesorët e ngjashme me to për përdorim në sistemet elektronike të shtëpive dhe ndërtesave	2008	Fp
	S SH EN 50428:2005/A1:2007		Fp
	S SH EN 50428: 2005/A2:2009	2009	Fp
33.	S SH EN 50470-1:2006 Pajisje të matjes së elektricitetit(a.c) - Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme, provat dhe kushtet e provave - Pajisjet matëse (Indekset e klasës A,B, dhe C)	2008	Fp
34.	S SH EN 50490:2008 Instalime elektrike për ndriçimin dhe sinjalizimin e aerodromeve - Kërkesat teknike për sistemet e kontrollit dhe monitorimit të ndriçimit tokësor aeronautik - Njësitë për ç'kyçjen përzgjedhëse dhe monitorimin e llambave individuale	2010	Fp
35.	S SH EN 50491-5-1:2010 Kërkesa të përgjithme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-1: Kërkesa EMC, kushte dhe ndërtimi i provës	2011	Fp
36.	S SH EN 50491-5-2:2010 Kërkesa të përgjithme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-2: Kërkesa EMC për HBES/BACS të përdorura në ambjente rezidenciale, tregtare dhe të industrisë së lehtë	2011	Fp
37.	S SH EN 50491-5-3:2010 Kërkesa të përgjithme për Sisteme Elektronike të Ndërtesave dhe Banesave (HBES) dhe Sisteme të Automatizimit dhe Kontrollit të Ndërtesave (BACS) - Pjesa 5-3: Kërkesa EMC për HBES/BACS të përdorura në ambjente të industrisë	2011	Fp
38.	S SH EN 50498:2010 Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) – Standard i familjes së produkteve për përdorim si pjesë këmbimi në pajisjet elektronike në automjete	2011	Fp
39.	S SH EN 50512:2009 Instalime elektrike për ndriçimin dhe sinjalizimin e aerodromeve -	2011	Fp



	Sistemet vizuale të avancuara për udhëzimin e uljes (A-VDGS)		
40.	S SH EN 50529-1:2010 Standard i rrjetave EMC – Pjesa 1: Rrjetat e telekomunikacionit që përdorin linja telefonike	2011	Fp
41.	S SH EN 50529-2:2010 Standard i rrjetave EMC – Pjesa 2: Rrjetat e telekomunikacionit që përdorin kablllo koaksialë	2011	Fp
42.	S SH EN 50550:2011 Pajisjet mbrojtëse kundër mbitensionit me frekuencë industriale për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to	2012	Fp
	S SH EN 50550:2011/A1:2014	2015	Fp
	S SH EN 50550:2011/AC:2012	2012	Fp
43.	S SH EN 50557:2011 Kërkesat për pajisjet për rimbylljen automatike (ARDs) për ndërprerësit e qarkut RCBO-RCCB për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to	2013	Fp
44.	S SH EN 50561-1:2013 Aparatet e komunikimit të linjave të transmetimit të përdorura në instalimet me tension të ulët - Karakteristikat e radio zhurmave - Limitet dhe metodat e matjes - Pjesa 1: Aparatet për përdorim në ambientet e shtëpisë	2014	Fp
45.	S SH EN 55011:2009 Pajisje industriale, shkencore dhe mjekësore - Karakteristikat e çrregullimeve radioelektrike - Limitet dhe metodat e matjes	2010	Fp
	S SH EN 55011:2009/A1:2010	2011	Fp
